

VENDIM
Nr. 53, datë 20.12.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 5, DATË 22.2.2023, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.12.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 5, datë 22.2.2023, ‘Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.’”

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë me shkresën nr. 19164 prot., datë 13.12.2024, me lëndë “Njoftim për ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë, me vendimin nr. 5, datë 22.2.2023, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, përpunimin e ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë z. Kostandin Budurushi ka përfunduar studimet e larta në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, dega Teknolog, në vitin 1990, dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknikë, në vitin 2004.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë të kërkesave të ligjit nr. 8102; të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2(a) të vendimit të KKRR-së nr. 5, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: z. Kostandin Budurushi.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
Evis Shurdha